



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 477/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bashkim Ademaj në cilësinë e Zyrtarit të lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ), në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Istog, për shkak të mbajtjes së tubimit politik të pa paralajmëruar, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Bashkim Ademaj, në cilësinë e Zyrtarit të lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ) dega në Istog, kështu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Istog, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 550 (550) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 04.11.2013, nga Bashkim Ademaj, në cilësinë e Zyrtarit të Lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ), në Istog, në të cilën theksohet se me datën 31.10.2013, rreth orës 17:00, derisa në objektin e shkollës fillore në Vrellë, ishte duke filluar një tubim i aprovuar elektoral i subjektit politik LDK, në restaurantin “Guri”, që gjendet përballë kësaj shkolle rreth 80 deri në 100 metra, subjekti politik AAK, ka filluar përgatitjet e tubimit të tyre të pa lajmëruar duke lëshuar muzikë me ton të lartë. Gjithashtu në ankesë theksohet se rreth orës 18:11 minuta, përderisa anëtarët e LDK-së pas përfundimit të tubimit kishin dal në oborr të shkollës duke vallëzuar, simpatizantët e AAK-së rreth 100 persona kanë parakaluar këmbë rrugës me muzikë, dhe në mesin e tyre ishin edhe Ramush Haradinaj, Donika Kadaj – Bujupi, Gani Dreshaj, Idriz Blakaj, Xhevat Demaj. Po ashtu parashtruesi i ankesës thekson se në restaurantin “Guri”, rreth orës 18:25, kanë filluar fushatën e tyre parazgjedhore, ku kanë kërkuar votën nga pjesëmarrësit e këtij tubimi që ishin rreth 300 persona, ku fjalim mbajtën: Ramush Haradinaj, Donika Kadaj – Bujupi, Gani Dreshaj, Idriz Blakaj Xhevat Demaj, fjalimi përfundoi rreth orës 18:55, e pastaj kanë vazhduar me darkën solemne deri në ora 19:40. Tubimi ka përfunduar i qetë dhe pa incidente, theksohet në ankesë.

Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës, raportin policor.

Në raportin policor nga rreshteri policor Sylë Mehmetukaj, po ashtu theksohet se me datën 31.10.2013, në objektin e shkollës fillore “Hysni Zajmi”, subjekti politik AAK, ka filluar parapërgatitjet e tubimit të tyre të pa lajmëruar, pastaj kanë shkuar në

restaurantin "Guri", ku kanë filluar fushatën e tyre parazgjedhore ku kanë kërkuar votën e tyre nga pjesëmarrësit e këtij tubimi që ishin rreth 300 persona, ndërsa për të pranishmit kanë mbajtur fjalim Ramush Haradinaj, Donika Kadaj Bujupi, Gani Dreshaj, Idriz Blakaj dhe Xhevat Demaj, pastaj kanë vazhduar darkën solemne, si dhe tubimi ka përfunduar i qetë dhe pa asnjë incident.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK, në kuptim të Nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 04.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 05.11.2013. Sipas afatit të caktuar, PZAP-i mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK, në të cilën theksohet se darka që është mbajtur me datë 31.10.2013, në Istog, në restorant Guri nuk ka qenë tubim politik por darkë me strukturat e nëndegës së Vrellës, po ashtu AAK deklaroi se Bashkim Ademaj është vëllau i nënkryetarit të Komunës së Istogut Agim Ademaj nga radhët e LDK-së, dhe këtu kemi të bëjmë me keqpërdorim të drejtës së ankesës dhe pretendimet e tij tendencioze kundër degës së AAK-së në Istog.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Pretendimet ankimore në ankesën e Bashkim Ademaj, në cilësinë e Zyrtarit të Lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ), në Istog, lidhur me mbajtjen tubimit politik të pa lajmëruar nga subjekti politik AAK, PZAP-i, konstatoi se janë të bazuara, pasi që neni 4.2 i Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, lidhur me Fushatën Zgjedhore dhe Njoftimin lidhur me Ngjarjet Politike, theksohet se subjekti i certifikuar politik që dëshiron të organizojë dhe të mbajë një tubim publik gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, duhet që të Zyrtari i Lartë Komunal i Zgjedhjeve i asaj Komune (ZLKZ), të dorëzojë formularin e plotësuar të Njoftimit për Mbajtjen e Tubimit Politik (FNJMTP), më së voni shtatëdhjetë e dy (72) orë përpara. Si rrethanë rënduese PZAP, mori se, subjekti politik AAK, shkeljet e natyrës së tillë i ka kryer edhe më parë, që konsiderohet si recidivist, gjë që e bën përgjegjës këtë subjekt politik. Prandaj PZAP, duke u mbështetur në dispozitën ligjore, konstatoi se subjekti politik AAK, nuk e ka njoftuar organin kompetent komunal në këtë rast ZLKZ-në, për mbajtjen e këtij tubimi, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 dhe neni 120.1.c të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

Anr. 477/2013 më datën 07.11.2013.



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoja e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*